REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 963/20
Datë/Datum. 17.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**203-20-3525-2-1-1**
Nr i brendshëm	**MBPZHR203-20-002-211**

Sa i përket tenderit për: **"Shërbimet të kontrollit dhe zhvillimit të kulturave bujqësore përmes imazheve satelitore".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NTSH "INFRATEK"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Bedri Shala 38C

(Adresa)

Prishtinë — *10 000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

00383 38 606 808 — *N/A*

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Veton JAHAJ

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@infratek.eu

(Adresa elektronike)

16.11.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 16.07.2020 Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 11.08.2020 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit 28.10.2020 Kërkesa për rishqyrtim me dt:02.11.2020 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt:09.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 56 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 62 i LPP-së** **Neni 64 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së** **Neni 72 i LPP-së** **Neni 44.5 i RROUPP-së.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, ne me dt.28.10.2020 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin se nuk janë përmbushur kërkesat:

III 2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

***Kërkesa 1**- Njëri OE Deklaratën nën Betim e ka nënshkruar një person i cili nuk posedon autorizim të noterizuar për përfaqësim të kompanisë*
***Kërkesa 2** - Dy OE nuk kanë sjellë Vërtetimin nga Gjykata Themelore*
***Kërkesa 3** - Njeri OE nuk ka sjellë Vërtetimin nga ATK*

- ***III.2.2) Përshtatshmëria profesionale***

***Kërkesa 2** - Dy OE nuk kanë sjellë Certifikatën e TVSH-së*

- ***III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:***

***Kërkesa 1** - Mungon Diploma adekuate*
***Kërkesa 3** - Ekspertit i mungon certifikata nga prodhuesi i dronit*
***Kërkesa 5** - Njërit ekspert i mungon Diploma adekuate*
***Kërkesa 7** - Grupi i OE nuk përmbushet kriteri minimal prej 1,935,000.00 €*
***Kërkesa 8** - Mungon kontrata me prodhuesin e imazheve satelitore*
***Kërkesa 9** - Konzorciumi nuk posedon Dron - por ka marrë në shfrytëzim një DRON*",

ndërsa e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat janë të papërgjegjshme.

Ju sqarojmë se arsyet e AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit nuk qëndrojnë për faktet si në vijim:

Sa i përket arsyes së parë të AK-së për eliminimin tonë ku e ka cekur se nuk e kemi plotësuar kërkesën në lidhje me pikën III 2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë, Kërkesa 1 - Njëri OE Deklaratën nën Betim e ka nënshkruar një person i cili nuk posedon autorizim të noterizuar për përfaqësim të kompanisë, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është absurd dhe nuk qëndron për faktin se ne në ofertën tonë e kemi bashkangjitur autorizimin për z. Veton JAHAJ për nënshkrimin e dosjes në fjalë i cili është origjinal, i cili autorizim është konform kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Gjithashtu ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar sepse askund në FDT dhe tek njoftimi për kontratë nuk është kërkuar që autorizimi të jetë i noterizuar, andaj ne po diskriminohemi në këtë aktivitet të prokurimit nga ana e AK-së pasi që po eliminohemi për kërkesa të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë. **(Bashkangjitur keni edhe një herë autorizimin origjinal).**

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së ku shkruan qartë se "*56.3 Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*"

Ndërsa sa i përket arsyes së dytë të AK-së për eliminimin tonë ku e ka cekur se nuk e kemi plotësuar kërkesën 2 tek kërkesat e përshtatshmërisë Dy OE nuk kanë sjellë Vërtetimin nga Gjykata Themelore, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron për faktin se në Dosje së Tenderit tek Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, Pika 6.4, është e cekur shumë qartë se: "Dëshmi se kompania nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore

lëshuar nga Gjykata Themelore- kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar jo më e vjetër 30 ditë, ***(mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorëzuar nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës)***".

Pra në kërkesën e lartcekur është shumë i qartë fakti se mosdorëzimi i Vërtetimit nga Gjykata Themelore nuk është kriter kualifikues/diskualifikues, andaj duke u bazuar në faktin e lartcekur shihet qartë diskriminimi që po i bëhet kompanisë tonë nga ana e AK-së pasi që po eliminohemi për arsye të cilat nuk janë aspak të bazuara dhe njëkohësisht absurde, ose lirisht mund të themi se po eliminohemi nga ana e AK-së në mënyrë të qëllimshme.

Gjithashtu në lidhje me arsyen e tretë të AK-së ku e ka cekur se Njëri OE nuk ka sjellë Vërtetimin nga ATK-ja, ju sqarojmë se as kjo arsye e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron sepse siç e cekëm më lartë mosdorëzimi i Vërtetimit nga ATK-ja nuk është kriter diskualifikues/kualifikues dhe nuk është dashur të eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit, për arsye të pa bazuara.

Këto dëshmi kërkohen nga tenderuesi që ka për qëllim dhënien e kontratës, prandaj edhe në këtë rast eliminimi është bërë në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Në lidhje me arsyen tjetër të AK-së për eliminimin tonë ku e ka cekur se nuk i kemi përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë profesionale përkatësisht Kërkesën 2 - Dy OE nuk kanë sjellë Certifikatën e TVSH-së, ju sqarojmë se edhe kjo arsye e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron dhe është e pa bazuar sepse në dosjen e aplikimit të tenderit, operatori ekonomik Abkons sh.p.k dhe Oikon d.o.o shihet qartë se të dy anëtarët e konzorciumit e kanë dorëzuar dokumentacionin ligjor provues "Ekstraktin e Regjistrit Tregëtar" të lëshuar nga organet kompetente të vendit të tyre të origjinës, i cili përmban numrin e regjistrimit të shoqërisë dhe numrin e TVSH-së dëshmi këto që e përmbushin kërkesën të cilën AK-ja ka pretenduar se nuk e përmbushim ne si grup i OE. Mirëpo edhe kur mungon certifikata e TVSH lejohen të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 39 të RRUOPP, dhe nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.
Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ne e përmbushim kërkesën e lartcekur.

Ndërsa në lidhje me arsyen tjetër për eliminimin tonë ku AK-ja e ka cekur se sa i përket pikës III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, Kërkesa 1 - Mungon Diploma adekuate, ju sqarojmë se as ky arsyetim i AK-së nuk qëndron dhe është i pa bazuar pasi që ne si Grup i operatorëve ekonomikë "N.T.SH. Infratek dhe Abkons sh.p.k dhe Oikon d.o.o" kemi prezantuar në pozicionin e Menaxherit të Projektit Z. Stefan Lang, i cili shihet qartë se zotëron Diplomën me Doktoraturën në Shkenca Natyrore- Gjeografi që përmban fushat "*Remote Sensing; Landscape ecology*"; Diplomë Masteri në Gjeografi që përmban fushat "….. *Comparative cultural and social geography; Applied landscape ecologies…*" Diplomë në Gjeografi që përmban fushat "*Remote Sensing; Landscape ecology*", pra diploma e prezanatuar nga ana jonë në lidhje me menaxherin e lartcekur shihet qartë se e përmbush kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ky arsyetim i AK-së është absurd dhe tregon jo seriozitetin e saj në lidhje me ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertës tonë pasi që me këtë arsye të AK-së po krijohet përshtypja se nuk e ka analizuar fare ofertën tonë. Gjithashtu në lidhje me arsyen e AK-së për eliminimin tonë, me këtë veprim të AK-së në lidhje me ekspertin e prezantuar nga ne po paragjykohet profesionalizmi i ekspertit të prezantuar nga ne në lidhje me pretendimin për diplomë jo-adekuate.
Theksojmë se ky ekspert që nga viti 1999 është i angazhuar si Lektor pranë Universitetit te Salzburgut si dhe si Ekspert Konsulent në fushat e studimit të parashikuara në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2 të dosjes se tenderit.

Në lidhje me arsyen e AK-së për eliminimin tonë për Kërkesën 3 ku e ka cekur se Ekspertit i mungon certifikata nga prodhuesi i Dronit, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i AK-së është plotësisht i pa bazuar pasi që eksperti i angazhuar nga ana jonë është i pajisur me Certifikatë, nga DPO Crew Academy në Gjermani, që është institucion i Autorizuar dhe Licencuar nga prodhues Droni për

ofrimin e trajnimeve profesionale në fushën e pilotimit të Dronit, për më tepër që ata zotërojnë prototipet e tyre të Droneve, andaj shihet qartë se arsyeja e lartcekur e AK-së për eliminimin tonë është absurde dhe nuk qëndron, pasi që eksperti i prezantuar nga ana jonë e plotëson kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Sa i përket pretendimit të AK-së në lidhje me Kërkesën 5 ku e ka cekur se njërit ekspert i mungon Diploma adekuate, ky pretendim i AK-së nuk qëndron për faktin se ne si grup i operatorëve ekonomikë "N.T.SH. Infratek dhe Abkons sh.p.k dhe Oikon d.o.o" kemi prezantuar në pozicionin e Ekspertit të Bujqësisë një ekspert që zotëron Diplomë në *"Biotechnical Forestry"*, e cila bën pjesë në shkencat e tokës dhe plotëson tërësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2 të dosjes se tenderit. Ndërsa është për tu veçuar eksperienca e gjerë profesionale të tij në analizën e të dhënave të kulturave bujqësore. Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se eksperti i prezantuar nga ne i plotëson kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj edhe pretendimi i AK-së në lidhje me ekspertin e lartcekur është i pa bazuar.

Në lidhje me arsyetimin tjetër të AK-së për eliminimin tonë ku e ka cekur se Grupi i OE nuk përmbush kriterin minimal prej 1,935,000.00 €, ju sqarojmë se ky pretendim i AK-së është krejtësisht i pa bazuar për faktin se mjafton vetëm ti referohemi disa projekteve në mënyrë nominative dhe rezulton se vlera e shërbimeve të ngjashme jo vetëm që plotësohet vlera e kërkuar në dosje të tenderit por tejkalohet disa herë.

Ndërsa sa për korrektësi po ju bashkangjesim vetëm disa nga projektet me anë të se cilave përmbushet kërkesa e lartcekur e FDT-së dhe njoftimit për kontratë:

- *Master Service Agreement – Land Easement and Acquisition Services - Trans Adriatic Pipeline;*
- *Sustainable Rural Development Project per GIZ;*
- *Development of Integrated Forest and Pastures Management Plans 4 Municipalities;*
- *Project for the determination of areas with natural or other specific constraints with calculations and assessments of the context value of indicator no.41 "Soil organic matter" and no.42 "Soil erosion by water" for the Program period 2021- 2027 (LFA);*
- *Assessment of the achievements and impacts of the Rural Development Programme of the Republic of Slovenia for the period 2014 – 2020;*
- *Development of expert background study for characterization and delineation of hilly and mountainous areas;*
- *Application of High Definition Multispectral Satellite Surveys in Determining the Degree of Productivity and Various Forest Owner's Forests in the Mediterranean and Sub-Mediterranean;*
- *Carbon sink assessment in dead organic matter and average wood stock assessment in maquis, thickets and first age class stands in Croatian forests;*

Study of Areas with Natural Constraints in Agriculture and Calculation Design (Preparation of Calculation), ref.no. No: MNE-MIDAS-TF093405-CS-CQ- 16-2.1.A.8.4.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ne e përmbushim kërkesën e lartcekur dhe se pretendimi i AK-së nuk qëndron. Ne edhe një herë sa për korrektësi po ju bashkangjesim listën e kontratave dhe kërkojmë nga ana juaj që ta detyroni AK ti analizoj edhe një herë dhe të merr një vendim sa më meritor në lidhje me kontratat e prezantuara nga ne, pasi që siç e cekëm më lartë ne e përmbushim kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.
Sa i përket arsyes tjetër të AK-së për eliminimin tonë ku e ka cekur se ju mungon kontrata me prodhuesin e imazheve satelitore, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së nuk qëndron për faktin se ne si grup i OE "N.T.SH. Infratek dhe Abkons sh.p.k dhe Oikon d.o.o" kemi prezantuar një kontratë me palë Abkons shpk dhe Vekom", ku ky i fundit është Subjekt i autorizuar i European Space Image.

Nga ana tjetër ju sqarojmë se përveç kontratës bashkangjitur gjendet dhe shkresa mbështetëse që tregon qartë se Abkons si klient i Vekom mbështetet në këtë pjesë të veprimtarisë nga European Space Image si dhe Vekom është distributor i autorizuar i imazheve satelitore në Ballkan, të prodhuara nga European Space Image.
Andaj duke u bazuar në faktin e lartcekur është për tu habitur se si AK-ja ka ardhur në përfundim se mungon kontrata me prodhuesin e imazheve satelitore, përderisa ne si grup i OE e përmbushim kërkesën e lartcekur të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, pra ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar dhe nuk qëndron.

Po ashtu sa i përket arsyes së AK-së në lidhje me eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit ku e ka cekur se nuk e përmbushim Kërkesën 9 - Konzorciumi nuk posedon Dron - por ka marrë në shfrytëzim një DRON, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së nuk qëndron për faktin se ne si Grup i operatorëve ekonomik "N.T.SH. Infratek dhe Abkons sh.p.k dhe Oikon d.o.o" për pajisjen Dron kemi prezantuar si dëshmi për pronësinë e Dronit faturën e pagesës e cila e përmbush kërkesën e specifikuar në Dosjen e Tenderit. Gjithashtu duhet theksuar se ne si Grup i operatoreve ekonomik kemi dorëzuar si dëshmi, "Faturën" ku specifikohet lloji i Dronit që është në pronësi të anëtarit Oikon d.o.o, dëshmi këto të cilat janë konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Ndërsa, në lidhje me kërkesën e AK-së për posedim të kamerës radiometrike, për të cilën sipas Kërkesave të dosjes së tenderit nuk është kërkuar ndonjë dëshmi provuese, ne si grup i operatoreve ekonomikë për të qenë sa më korrekt gjithsesi kemi prezantuar si dëshmi kontratë qiraje për këtë pajisje.

Andaj arsyetimi i AK-së për mangësi në posedim pajisjesh nuk është i bazuar. Për më tepër një arsyetim i tillë nuk mund të konsiderohet si diskualifikues, për sa kohë në FDT dhe tek njoftimi për kontratë për një pajisje (kamera radiometrike) nuk është kërkuar dëshmi, mirëpo edhe pse nuk janë kërkuar dëshmi për paisjen në fjalë nga ana jonë është prezantuar dëshmia si dokument mbështetës provues.
Për më tepër që termi posedim, ligjërisht nuk prezumohet vetëm si pronësi, por është i ligjshëm edhe kur poseduesi e ka në posedim nga pronari, në bazë të një veprimi juridik, në bazë të ligjit ose të një akti administrativ.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se arsyet e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndrojnë, pasi që ne i kemi përmbushur të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe nuk është dashur të eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit.

Po ashtu në lidhje me të gjitha arsyet e AK-së për eliminimin tonë nëse AK-ja ka pasur ndonjë dyshim në lidhje me dëshmitë e prezantuara nga ne ka mundur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe ne do të ju kishim ofruar sqarimet e nevojshme, mirëpo AK-ja nuk i ka shfrytëzuar dispozitat e lartcekura duke na diskriminuar neve si OE i cili i përmbush të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë kërkojmë nga ju që të detyroni AK që ta rishqyrtoj njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe që të analizoj në detaje secilin dokument tonin të ofruar dhe të vie në përfundime të sakta dhe të drejta në lidhje me ofertën tonë sepse shumë qartë kuptohet dhe vërtetohet se ne jo vetëm që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, mirëpo i kemi ofruar edhe më shumë paisje dhe stabilimente teknike se sa që është kërkuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.
Ne me dt.30.10.2020 kemi pasur qasje në dokumentacionin e OE MESCIOGLU MUHENDISLIK VE MUSAVIRLIK A.S& URBAN METROPOL SHPK i cili është me çmim më të lirë se ne dhe e kemi vërejtur se ky OE është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i lartcekur është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat tek mundësitë teknike dhe/ose profesionale tek neni 9.1&9.2 ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa 2. Tre ekspert te analizës se imazheve satelitore me kualifikim minimum Master i shkencave në Gjeomatikë, Hartografi ose Gjeoinformatike me përvojë se paku 3 vjeçare pas diplomimit ne Msc. Duhet te dëshmojnë njohuritë ne analizën e imazheve satelitore përmes certifikatës nga trajnimi për këtë"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Dëshmia 2 OE duhet të ofroj dëshmi diplomën, CV, Referenca që ka përvojën pune së paku 3 vite pas diplomimit. Kopja e certifikatës për analize te imazheve satelitore."*. OE i lartcekur nuk e plotëson kërkesën e lartpërmendur sepse njërit nga ekspertët e prezantuar në ofertë i mungon kopja e certifikatës për analize të imazheve satelitore, andaj shihet qartë se është i papërgjegjshëm ky OE.

Po ashtu OE MESCIOGLU MUHENDISLIK VE MUSAVIRLIK A.S& URBAN METROPOL SHPK është i papërgjegjshëm edhe për faktin nuk e ka plotësuar kërkesën 3 tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa 3. Një ekspert për matje fotogrametrike përmes Dronit me kualifikim se paku Bachelor ne Gjeodezi, Hartografi apo Gjeoinformatike me përvojë së paku 3 vjeçare pas diplomimit. Duhet të dëshmojë njohuritë ne rilevim me dron përmes certifikatës nga trajnimi për këtë"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Dëshmia 3 OE duhet të ofroj dëshmi diplomën, CV, Referenca që ka përvojën pune së paku 3 vite pas diplomimit. Kopja e certifikatës për rilevim me dron."* Ekspertin që e ka prezantuar OE i lartcekur z. Abdullah Yusuf Ekina nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se ekspertit të lartcekur i mungon kopja e certifikatës për rivelim me dron dhe gjithashtu diplomën e prezantuar nuk e ka të përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare, andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ky OE është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu OE i lartpërmendur është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka përmbushur kërkesën 4 tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa 4. Dy ekspert të gjeoinformatikes për përpunimin e të dhënave hapësinore me qellim krijimin e raporteve nga analizat hapësinore, si dhe matjet kontrolluese me Dron, me kualifikime se paku Bachelor në Gjeodezi ose Gjeoinformatike, me përvojë së paku 5 vjeçare pas diplomimit."*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Dëshmia 4 OE duhet të ofroj dëshmi diplomën, CV, Referenca që ka përvojën pune së paku 5 vite pas diplomimit."* OE në fjalë nuk e plotëson këtë kërkesë për faktin se njëri nga ekspertët e prezantuar nga OE i lartcekur me saktësisht z. Ozgur Kaya ka dorëzuar një Diplomë te bachelorit në të cilën diplomë nuk ka asnjë datë kur është lëshuar kjo diplomë, ndërsa siç edhe e dini, çdo diplomë përmban datën se kur është lëshuar diploma, andaj OE i lartpërmendur shihet qartë se nuk e posedon ekspertin e kërkuar dhe nuk e përmbush kërkesën e lartpërmendur, andaj edhe është i papërgjegjshëm.

OE MESCIOGLU MUHENDISLIK VE MUSAVIRLIK A.S& URBAN METROPOL SHPK është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka plotësuar kërkesën 5 tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa 5. Dy ekspert te bujqësisë për analizën dhe përpunimin e te dhënave për kulturat bujqësore, me kualifikim se paku Master i shkencave te tokës dhe përvojë profesionale se paku 3 vite pas diplomimit master"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Dëshmia 5 OE duhet të ofroj dëshmi diplomën, CV, Referenca që ka përvojën pune së paku 3 vite pas diplomimit ne përpunimin e parametrave biofizik apo NDVI."* Ky OE është i papërgjegjshëm sepse në lidhje me ekspertët e bujqësisë, OE në fjalë ka prezantuar z. Yakup Ergun, mirëpo që ky ekspert nuk e plotëson kërkesën e lartcekur sepse kërkesa ka qenë shumë e qartë që ekspertët e prezantuar duhet të jenë të diplomuar më së paku në nivelin master, ndërsa OE i lartcekur e ka ofruar njërin nga ekspertët bachelor që nuk është konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj shihet qartë se ky OE është i papërgjegjshëm.

Po ashtu OE i lartpërmendur është i papërgjegjshëm edhe për faktin se ky OE nuk e ka plotësuar kërkesën 6 tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa 6. Një ekspert i*

biologjisë për analizën e parametrave biofizik, me kualifikim se paku Master i shkencave ne Biologji, dhe përvojë profesionale se paku 3 vite pas diplomimit master", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Dëshmia 6 OE duhet të ofroj dëshmi diplomën, CV, Referenca që ka përvojën pune së paku 3 vite pas diplomimit. OE për të gjithë ekspertet e ofruar sipas kërkesave 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 duhet të dëshmojë me kontratë të rregullt te punës apo kontrate për angazhim në këtë projekt"*. OE i lartcekur nuk e plotëson këtë kërkesë për faktin se në lidhje me ekspertin e biologjisë, OE në fjalë ka prezantuar disa dokumente për z. Esref Yegun, mirëpo në dokumentet e prezantuara shihet qartë se mungon diploma për ekspertin e lartcekur, andaj shihet qartë se nuk është plotësuar kërkesa e lartcekur e FDT-së dhe e njoftimit për kontratë, andaj edhe për këtë arsye OE i lartpërmendur është i papërgjegjshëm.

OE MESCIOGLU MUHENDISLIK VE MUSAVIRLIK A.S& URBAN METROPOL SHPK është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka plotësuar kërkesën 8 tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1&9.2 ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa 8 OE duhet te dëshmojë qe posedon sisteme satelitore për fotografim me rezolucion prej 50cm ose me te mire. Ose, është i autorizuar nga prodhuesi i imazheve satelitore për shitje në territorin e Kosovës"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Dëshmia 8 Kontrata me prodhuesin e imazheve satelitore e lidhur para datës se publikimit te këtij njoftimi. Dhe njoftimi nga kompania për posedimin e këtij produkti sipas specifikave"*. - OE në fjalë nuk e plotëson këtë kërkesë për faktin se i mungon kontrata me prodhuesin e imazheve satelitore e lidhur para datës së publikimit të njoftimit për kontratë, ndërsa ky OE ka ofruar dy autorizime nga dy prodhues të ndryshëm nga ai MIR GeoSpatial Technology Solutions Engineering & Foreign Trade LLC si dhe nga Nik Insaat Ticaret mirëpo në dosje të tenderit përkatësisht tek neni 4.1 është e cekur shumë qartë se **variantet nuk lejohen.**

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE MESCIOGLU MUHENDISLIK VE MUSAVIRLIK A.S& URBAN METROPOL SHPK i cili është me çmim më të lirë se ne është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ashtu siç e cekëm edhe më lartë.

Ne me dt. 09.11.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.

Sa i përket arsyes së AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ku e ka cekur se z. Veton Jahaj ka nënshkruar deklaratën nën betim edhe pse nuk është pronar apo i autorizuar në certifikatën e biznesit, ndërsa pastaj e ka cekur se ka një autorizim mirëpo i njëjti nuk është i noterizuar. Ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është krejtësisht i pa bazuar dhe njëkohësisht absurd pasi që ne e kemi cekur shumë qartë se z. Veton Jahaj është person i autorizuar dhe ne e kemi bashkangjitur autorizimin, i cili autorizim është konform kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Andaj arsyetim i AK-së është i pa bazuar sepse askund në FDT dhe tek njoftimi për kontratë nuk është kërkuar që autorizimi të jetë i noterizuar. Ky veprim i AK-së e tregon qartë diskriminimi që po na bëhet neve si OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, pasi që po eliminohemi për kërkesa të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë. Ne edhe pse i ja kemi bashkangjitur AK-së autorizimin origjinal AK-ja përsëri po mundohet të na eliminoje nga ky aktivitet i prokurimit pa ndonjë bazë ligjore.

Në lidhje me arsyen tjetër të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ku AK-ja e ka cekur se kinse OE N.T.SH INFRATEK nuk posedon veprimtarinë primare ose sekondare të kompanisë ku përfshihen natyra e ngjashme sipas njoftimit për kontratë dhe në FDT. Fillimisht ju sqarojmë se AK-ja me çdo kusht po mundohet të na eliminojë nga ky aktivitet i prokurimit pasi që ky pretendim i AK-së në nuk ka qenë në njoftimin mbi vendimin e AK-së. Mirëpo edhe pse ky pretendim nuk ka qenë në njoftimin mbi vendimin dhe AK-së tani i ka rënë ndër mend se ne nuk e përmbushim këtë

kërkesë, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së nuk qëndron për faktin se ne OE N.T.SH INFRATEK e posedon veprimtarinë primare dhe sekondare ashtu siç ka qenë kërkesa pra të natyrës së ngjashme. Andaj duke u bazuar në këtë fakt ky veprim i AK-së nuk mund të merret ndryshe përveç se diskriminim ndaj kompanisë tonë edhe pse jemi OE i përgjegjshëm po mundohet të na eliminojë nga ky aktivitet i prokurimit.

Sa i përket arsyes tjetër të AK-së ku e ka cekur se diploma e Stefan Lang-Mr. Në Gjeografi – është diplomë jo adekuate, ju sqarojmë se siç edhe e kemi cekur në kërkesë për rishqyrtim, ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar dhe njëkohësisht absurd pasi që ne e kemi cekur shumë qartë se Z. Stefan Lang zotëron Diplomën me Doktoraturën në Shkenca Natyrore- Gjeografi që përmban fushat "*Remote Sensing; Landscape ecology*"; Diplomë Masteri në Gjeografi që përmban fushat "….. *Comparative cultural and social geography; Applied landscape ecologies*…" Diplomë në Gjeografi që përmban fushat "*Remote Sensing; Landscape ecology*", pra diploma e prezanatuar nga ana jonë në lidhje me menaxherin e lartcekur shihet qartë se e përmbush kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ky arsyetim i AK-së është absurd dhe tregon jo seriozitetin e AK-së në lidhje me ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertës tonë pasi që me këtë arsye të AK-së të njëjtë sikurse në njoftimin mbi vendimin e AK-së po krijohet përshtypja se AK-ja nuk i ka analizuar fare ofertën tonë dhe faktet e prezantuara.

Në lidhje me arsyen tjetër të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ku e ka cekur se certifikata nga prodhuesi i droni për rivelim nuk është nga prodhuesi i dronit, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar pasi që ne e kemi sqaruar shumë qartë se eksperti i angazhuar nga ana jonë është i pajisur me Certifikatë, nga DPO Crew Academy në Gjermani, që është institucion i Autorizuar dhe Licencuar nga prodhues Droni për ofrimin e trajnimeve profesionale në fushën e pilotimit të Dronit, për më tepër që ata zotërojë prototipet e tyre të Droneve. Andaj përderisa ne e kemi sqaruar shumë qartë në kërkesën për rishqyrtim shihet qartë se AK-ja po mundohet qëllimisht të na eliminojë nga ky aktiviteti i prokurimit me arsye të cilat nuk janë të bazuara në asnjë dispozitë ligjore dhe për faktin se nuk ka ofruar asnjë dëshmi në lidhje me këto arsye, mirëpo vetëm e ka cekur se nuk është nga prodhuesi i dronit.

Sa i përket arsyes tjetër të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim në lidhje me kërkesën nr.5 tek kapaciteti teknik dhe profesional ku e ka cekur se diploma e ekspertit është jo adekuate, ju sqarojmë se edhe ky arsyetimi AK-së është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne kemi prezantuar në pozicionin e Ekspertit të Bujqësisë një ekspert që zotëron Diplomë në "*Biotechnical Forestry*", e cila bën pjesë në shkencat e tokës dhe plotëson tërësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2 të dosjes se tenderit. Andaj përderisa është prezantuar diploma konform kërkesës së FDT-së është për tu habitur se si AK-ja vjen në përfundim se diploma është adekuate.

Në lidhje me arsyen tjetër të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ku e ka cekur ese nuk e plotësoni kërkesën nr.7 tek kapaciteti teknik dhe profesional, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar pasi që në këtë rast AK-ja i është referuar kontratës Master Services Agreement, me klient TAP AG. Abkons ka klient TAP AG prej vitit 2014 e në vazhdim. Ndërkohë ne kemi paraqitur si kontratë të ngjashme amendimet Nr 1, 3 dhe 5 që lidhen me scope të ngjashëm dhe janë të periudhës 01.2015 deri më 12.2017, ndërsa letra e referencës është marr në vitin 2016 dhe nuk është që lidhet me përfundimin e punimeve, për me tepër edhe nëse do të shihet në letër referencë progresi i taskeve nuk është 100% në datën e letrës se referencës. Andaj konstatimi i AK-së se kontrata e lartcekur ka filluar në vitin 2014 dhe ka mbaruar ne vitin 2016 është krejtësisht i gabuar ashtu siç e cekëm më lartë, pra kontrata e lartcekur është brenda afateve të pranimit, që tregon qartë se ne e tejkalojmë shumë herë vlerën e kërkuar në dosje të tenderit. Ndërsa në lidhje me kontratat tjera ne e kemi cekur shumë qartë se e plotësojmë vlerën e kërkuar, ky AK-ja ka mundur ti analizoj mirëpo që një veprim të tillë nuk e ka bërë.

Po ashtu sa i përket arsyes tjetër të AK-së ku e ka cekur se nuk e plotësojmë kërkesën nr. 8 tek kapaciteti teknik dhe profesional ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar. Sepse siç edhe e kemi sqaruar , ne kemi kontrate me distributorin e autorizuar te imazheve satelitore si dhe letër suporti qe prodhuesi i imazheve dëshmon suportin e prodhuesit përmes distributorit me të gjitha kërkesat sipas kontratës. Pra për ta përmbledhur, ne nuk kemi kontratë për të blerë imazhet satelitore prej një kompanie tjetër qe i blen nga një prodhues. Ne kemi kontrate me një kompani qe është distributor i autorizuar i këtyre imazheve, ndërsa vlen të ceket edhe fakte se ne posedojmë edhe letër support prej prodhuesit. Andaj duke u bazuar në faktin e lartcekur shihet qartë se si AK-ja po mundohet të eliminojë nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse ne jemi OE i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Në lidhje me arsyen tjetër të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ku e e ka cekur se nuk e plotësojmë kërkesën nr.9 tek kapaciteti teknik dhe profesional ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshme sepse ne e kemi cekur shumë qartë edhe në kërkesën për rishqyrtim se DUD doganor është dokumenti që vërteton blerjen e një pajisje kur ajo blihet jashtë kufijve të subjektit, ndërkohë kur blihet brenda kufijve atëherë lëshohet faturë, dhe rasti i dronit është i tillë (kompania qe e ka shitur dhe kompania që e ka blerë janë të dyja kroate, dhe transaksioni dëshmohet përmes faturës dhe jo DUD-it doganor). Ndërsa në lidhje me arsyen tjetër të AK-së ku e ka cekur se konzorciumi nuk posedon dron por e ka marrë me qira nga Universiteti i Zagrebit, ju sqarojmë se AK-ja këtu tregon qartë faktin që po na diskriminon haptas pasi që pajisja që është kontratë qiraje me Universitetin e Zagrebit nuk është dron por është kamerë endotermike, për te cilën si dëshmi nuk është kërkuar që ajo të jetë në pronësi dhe si e tillë nuk përbën kriter diskualifikues.

Gjithashtu AK-ja nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona në lidhje me OE MESCIOGLU MUHENDISLIK VE MUSAVIRLIK A.S& URBAN METROPOL SHPK i cili është me çmim më të lirë se ne, ku me këtë veprim të saj i ka vërtetuar pretendimet tona ankimore, kundrejt OE të lartcekur.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura shihet qartë se ne si OE i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj edhe arsyet e lartcekura të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim janë të pa bazuara.

Pra duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se AK-ja e ka anuluar pa bazë këtë aktivitet të prokurimit dhe në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, pasi që tenderit jonë ka qenë në përputhje me aspektet përmbajtjesorë të tenderit, mirëpo AK-ja nuk na ka rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu ky anulim i këtij aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë.

AK-ja duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **NTSH "INFRATEK"**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe lënda kthehet në
RIVLERËSIM,
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 €.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*